



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

Nr. 32/1 prot  
Dt. 28/12/2020

Nr. Serial 00134

**AUTORIZIM  
PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR**

Nr.599 Prot., datë 28/12/2020

Miratuar me:

**VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR**

Nr.21, datë 24/12/2020

Emri i individit/subjektit: **“SIMA-COM” & “ROLAND” SH.P.K**  
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna (NID/NIPT): **L01505020G & K31327040D**  
Baseni Ujor: **DRIN-BUNË**  
Qarku: **SHKODËR**  
Bashkia/Njësia administrative: **PUKË / QELËZ**  
Koordinatat e veprës së marrjes: **X = 488700.17; Y = 4650258.57; Z = 574 m mnd;**  
Koordinatat e godinës së centralit: **X = 486517.45; Y = 4650296.95; Z = 405.6 m mnd;**  
Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji. **Për prodhim hidroenergjetik (H/C GOMSIQE E BJESHKËS).**  
Burimi ujor: **PËRROI I GOMSIQE E BJESHKËS.**  
Prurja mesatare vjetore **0.634 m<sup>3</sup>/s**  
Prurja ekologjike **0.08 m<sup>3</sup>/s**  
Sasia e ujit që jepet për përdorim **0.88 m<sup>3</sup>/s**  
Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka) **0.88 m<sup>3</sup>/s**  
Koordinatat ku do të shkarkohet rrjedha e kthyer: **X=486517.45; Y=4650296.95; Z=405.6 m.**  
Koordinatat e shkarkimit të ujërave të përdorura **Nuk ka**  
Sipërfaqja e tokës, së cilës i shërben përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes) **20 (ha)**  
Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka). **Të mos pengohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe prurja ekologjike.**  
Periudha e vlefshmërisë **24.12.2020 - 23.12.2025**  
Hyrja në fuqi **24.12.2020**

**KRYETAR  
MAJLINDA ANGONI**

### **Kushtet e posaçme të autorizimit për përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor**

1. Të përdorë ujërat në mënyrë racionale, duke shmangur mbetjet dhe duke mos dëmtuar mjedisin;
2. Të përdorë ujërat vetëm për qëllimet, për të cilat i është dhënë leja;
3. Të paguajë të gjitha kostot, taksat, tarifat në lidhje me përdorimin e ujit;
4. Të instalojë ose të lejojë instalimin e pajisjeve për matjen e sasisë së ujit të përdorur në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;
5. Të regjistrojë vëllimin ditor të ujit të përdorur, përfshirë dhe rrjedhën e kthyer, në një regjistër të posaçëm dhe të raportojë çdo 3 muaj pranë AMBU-së;
6. Të japë të dhëna dhe informacion për përdorimin e ujit sa herë që i kërkohet nga organet e ngarkuara për menaxhimin e burimeve ujore;
7. Kjo leje nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër, pa miratimin e organeve të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
8. Të respektojë kushtet e mbrojtjes së mjedisit dhe të rrethojë sipas projektit brezat sanitare të mbrojtjes;
9. Të mos dëmtojë brigjet dhe shtratin e burimit ujqor, gjatë ndërtimit dhe operimit të veprave;
10. Të mos ndryshojë rrjedhën natyrore të burimit ujqor, me përjashtim të rasteve kur kjo është e miratuar nga organet e administrimit të burimeve ujore;
11. Të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontroleve nga autoritetet përkatëse të ujit;
12. Të lejojë rrjedhën ekologjike;
13. Të sigurojë marrjen e menjëhershme të masave dhe veprimeve për të minimizuar, ose parandaluar ndonjë ndikim në mjedisin ujqor, ose në brigje në rast të një aksidenti, apo incidenti;
14. Të kompensojë dëmin e shkaktuar dhe të rikthejë mjedisin ujqor në gjendjen e mëparshme;
15. Të mos çënojë faunën dhe florën ujore e tokësore dhe të marrë masa për mbrojtjen e specieve të rralla;
16. Të sigurojë, nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, kushte për përdorimin e burimit ujqor nga subjekte të tjerë për sasinë e papërdorur;
17. Të zbatojë parimet dhe kushtet të tjera të përcaktuara në ligjin për menaxhimin e burimeve ujore për veprimtarinë përkatëse.